

RREGULLORE PËR ZGJEDHJET E STUDENTËVE, THEMELIMIN DHE PUNËN E
KËSHILLIT TË STUDENTËVE TË KOLEGJIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR TË BIZNESIT
NË MITROVICË (IBCM)

Nr. Prot. 859, Dt: 18.09.2024

Mitrovicë
Shtator, 2024

Në mbështetje të nenit 8 dhe 112 të Statutit të Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM), si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i IBCM, me datë 18.09.2024 miratoi:

RREGULLORE PËR ZGJEDHJET E STUDENTËVE, THEMELIMIN DHE PUNËN E KËSHILLIT TË STUDENTËVE TË KOLEGJIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR TË BIZNESIT NË MITROVICË (IBCM)

Neni 1

Qëllimi dhe përkufizimi

1. Kjo rregullore përcakton procedurën dhe organizimin e zgjedhjeve të studentëve, si dhe konstituimin dhe punën e Këshillit të Studentëve (KS).
2. Këshilli i Studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve.

Neni 2

Përfaqësimi në organet qeverisëse

1. Interesat e studentëve do të përfaqësohen në IBCM përmes Këshillit të Studentëve (KS).
2. Studentët të cilët kanë përsëritur vite të studimeve nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjidhen në pozita udhëheqëse studentore.
3. Studentët e studimeve themelore të cilët kanë notën mesatare më pak se shtatë (7) (sipas sistemit të notave të IBCM) nuk mund të kandidojnë për zgjedhje në organet përfaqësuese të studentëve.
4. Studentët e studimeve themelore dhe master të cilët kandidohen për KS propozohen duhet të kenë notën mesatare jo më pak se shtatë (7) (sipas sistemit të notave të IBCM) në nivelin e studimeve bachelor.
5. Nëse nota mesatare e përfaqësuesit të zgjedhur të studentëve në organet përfaqësuese të studentëve, gjatë ushtrimit të mandatit bie nën shtatë (7) (sipas sistemit të notave të IBCM), i njëjti nuk e humb mandatin e fituar në zgjedhje.
6. Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk mund të kandidohen për KS.
7. Me rastin e diplomimit, kandidati mandatar nuk mund të vazhdojë të mbajë mandatin e fituar gjatë kohës sa ishte student. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës të renditur në listën e certifikuar të kandidatëve.

Neni 3

Këshilli i Studentëve

1. Këshilli i Studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve.
2. Në bazë të nenit 17 të Statutit, Kryetari/rja e këshillit të studentëve ex officio është edhe anëtar i Këshillit Akademik të IBCM.
3. Këshilli i Studentëve vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe fokusohet në temat si në vijim:
 - 3.1. Interesat e studentëve në nivel të kolegjit;
 - 3.2. Angazhimi për cilësinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
 - 3.3. Zhvillimi i cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
 - 3.4. Bursat e studentëve;
 - 3.5. Ndihmat (bursat) sociale;
 - 3.6. Çështjet tjera të përgjithshme të interesave akademike të studentëve;
 - 3.7. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive.
4. Këshilli i Studentëve ka kompetenca si në vijim:
 - 4.1. Përfaqësimin në Këshillin Akademik të kolegjit si dhe në komisione të tjera, siç është e përcaktuar me Statut apo akte të tjera;
 - 4.2. Zhvillimin e aktiviteteve studentore në kuadër të kolegjit;
 - 4.3. Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e kolegjit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;
 - 4.4. Çështjet tjera të ngjashme.

Neni 4

Përbërja e Këshillit të Studentëve dhe Mandatet

1. Këshilli i Studentëve (KS) përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve.
2. Kandidimi për anëtar të KS është i hapur për të gjithë studentët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuar për zgjedhje sipas kësaj rregullore.
3. Regjistrimi i kandidaturës për anëtar të KS bëhet në mënyrë elektronike duke plotësuar formularin sipas **shtojcës 1** të kësaj rregullore, në një afat prej shtatë (7) ditësh para ditës së mbajtës së zgjedhjeve.

4. Formulari i plotësuar dorëzohet në formë elektronike adresën zyrtare të cilën e ofron në dispozicion KQZ.
5. Anëtarët e Këshillit të Studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.
6. Zgjedhjet e Këshillit të Studentëve do të udhëhiqen nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

Neni 5

Kohëzgjatja e Mandatit

1. Mandati i anëtarëve të KS zgjat 2 vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes.
2. Mandati i përfaqësuesit të zgjedhur në KS përfundon para kohe në rastet si në vijim:
 - 2.1. Me rastin e dorëheqjes;
 - 2.2. Me rastin e diplomimit të studentit të zgjedhur që ka fituar mandatin;
 - 2.3. Me rastin e humbjes së statusit të studentit që ka fituar mandatin;
 - 2.4. Në rast të shqiptimit të masës disiplinore për shkelje të rënda, me vendim të KS
 - 2.5. Në rast të ngritjes së aktakuzës apo dënimit për vepër penale.

Neni 6

Shpallja e Zgjedhjeve

1. Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i IBCM.
2. Zgjedhjet e studentëve mbahen jo më larg se 25 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues i IBCM. Data e saktë përcaktohet nga Këshilli Drejtues.
3. Kandidatët e certifikuar nga KQZ që fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore mund të mbajnë fushatën e tyre zgjedhore duke promovuar programin dhe idetë e tyre. Fushata mund të organizohet në formate të ndryshme por pa shkaktuar ndonjë dëmtim të pronës së IBCM, pa penguar procesin arsimor dhe të punës në IBCM.
4. Periudha e fushatës zgjedhore për anëtar të KS do të fillojë ditën e parë pas certifikimit të kandidatëve dhe do të përfundojë 24 orë para datës së zgjedhjeve. Duke e llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së shpalljes së zgjedhjeve, zgjedhjet do të udhëhiqen nga KQZ, ndërsa do të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë të tjera të interesit për monitorimin e zgjedhjeve.
5. Shkeljet e rregullave dhe procedurave zgjedhore do të sanksionohen nga KQZ dhe Këshilli Drejtues si shkallë e dytë.

Neni 7

Komisioni Qendror Zgjedhor – KQZ i IBCM

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të IBCM dhe rregulloreve në fuqi.
2. KQZ emërohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme për personel akademik. KQZ e IBCM është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të përgjithshme të IBCM-së, përfshirë edhe zgjedhjet studentore.
3. KQZ i IBCM përbëhet nga dy (2) profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në IBCM dhe sekretari i përgjithshëm i IBCM-së. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i KQZ zgjidhen nga radhët e profesorëve, kurse sekretari i përgjithshëm i IBCM-së është sekretar i KQZ të IBCM-së. Në cilësinë e vëzhguesit, pjesë e KQZ të IBCM-së është edhe një person nga shoqëria civile.
4. KQZ e IBCM zgjidhet me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ka mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.
5. Përgjegjësitë e KQZ të IBCM-së janë:
 - a) Përcaktimi dhe zbatimi i dinamikës së zgjedhjeve;
 - b) Përgatitja e listave për zgjedhje;
 - c) Nxjerrja e vendimeve për kundërshtimet kundër listës së zgjedhjeve;
 - d) Certifikimi i kandidaturave në zgjedhje;
 - e) Konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
 - f) Vlerësimi i listës së kandidatëve;
 - g) Kryesimi i procedurave zgjedhore;
 - h) Identifikimi i listave përfundimtare të atyre që kanë të drejtë vote;
 - i) Konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 - j) Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
 - k) Certifikimi i mandateve;
 - l) Zëvendësimi i mandatit;
 - m) Administrimi i zgjedhjeve në nivel të IBCM-së;
 - n) Nxjerrja e vendimeve lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve në të gjitha nivelet e IBCM-së;
 - o) Anulimi i procesit zgjedhor në rast të vërtetimit për parregullsi, sipas provave të dorëzuara;
 - p) Administrimi i konstituimit të Këshilli Akademik, organeve të tjera, sipas dinamikës zgjedhore;
 - q) Administrimi i periudhës paszgjedhore, përfshirë edhe zëvendësimin e mandateve, pas themelimit të organeve;
 - r) Administrimi i procesit zgjedhor, në rast të zgjedhjeve, pas themelimit të organeve, sipas kësaj rregulloreje;
 - s) Kryerja e detyrave të tjera, sipas kësaj rregulloreje, lidhur me procesin zgjedhor;

- t) Kryerja e detyrave të tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, bazuar në dinamikën zgjedhore të miratuar.
6. KQZ ka të drejtë të krijoj komisione të përkohshme, sikurse komisioni për ankesa dhe parashtrësia sipas nevojës.
 7. Për të gjitha rastet kur mandati në organet e IBCM-së për personat e zgjedhur sipas kësaj rregulloreje përfundon para kohe, përbërja e njëjtë e KQZ të IBCM-së është kompetente për zbatimin e procedurave përkitazi me zëvendësimin e mandatit respektiv.

Neni 8

Ankesat

1. Studentët kandidatë për zgjedhje kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve të KQZ sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Vendimi lidhur me ankesën sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të merret brenda dy (2) ditëve të punës pas pranimit të ankesës. Komisioni për ankesa dhe parashtrësia shqyrton ankesat dhe propozon vendimet tek KQZ, vendimi nga KQZ i IBCM është përfundimtar në procedurë administrative.
3. Studentët me të drejtë vote për zgjedhjen e organeve përkatëse kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek KQZ e IBCM, në lidhje me procedurat e zgjedhjeve.
4. Formulari përkatës, Shtojca nr. 2, do të jetë në dispozicion në secilin vendvotim dhe në ueb faqen e IBCM-së.
5. Në rastet kur KQZ i IBCM, pas shqyrtimit të ankesës, konstaton se ka pasur shkelje dhe mosrespektim të dispozitave të kësaj rregulloreje, mund të rekomandojë anulim të rezultateve dhe përsëritje të procesit zgjedhor. Vendimi përfundimtar merret nga Këshilli Drejtues.

Neni 9

Data e zgjedhjeve të përgjithshme

1. Këshilli Drejtues shpall datën e zgjedhjeve të studentëve. Zgjedhjet zhvillohen sipas dinamikës së përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet të hapen nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
3. KQZ duhet të shpall lokacionin e vendvotimeve.

Neni 10

Mënyra e votimit

1. Votuesit me të drejtë vote duhet të hedhin personalisht votën në kutinë e votimit në vendvotimet përkatëse.
2. Asnjë votues nuk ka të drejtë të votojë në më shumë se një vendvotim.
3. Vendvotimi duhet të jetë mjaftueshëm i madh për të siguruar zhvillimin e rregullt të votimit, duke garantuar fshehtësinë e votimit, kontroll të lirë të kutisë së votimit dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.

Neni 11

Mbikëqyrja e procesit zgjedhor

1. Zgjedhjet duhet të mbahen nga KQZ i IBCM.
2. Zgjedhjet mund të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë të tjera të interesit, në pajtim me Statutin e IBCM-së dhe legjislacionin përkatës.

Neni 12

Listat e studentëve me të drejtë vote

1. Listat përfundimtare të studentëve me të drejtë vote do të sigurohen nga KQZ-ja, me të gjitha të dhënat e studentëve që kanë të drejtë të votojnë, jo më vonë se 7 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të studentëve nga Këshilli Drejtues.
2. Studentët me të drejtë vote duhet të përmbushin këto dy kualifikime si më poshtë:
 - Të kenë statusin e studentit të rregullt, të përcaktuar në nenin 51, paragrafi 3 të Statutit të IBCM.
 - Të kenë ID kartën, që dëshmon se studenti është i regjistruar në vitin akademik në të cilin mbahen zgjedhjet.
3. Lista e studentëve që kanë të drejtë të votojnë duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për KQZ-në brenda pesë (5) ditëve pasi zgjedhjet të jenë shpallur nga Këshilli Drejtues.
4. Listat finale të studentëve me të drejtë vote do të publikohen jo më vonë se shtatë (7) ditë para datës së zgjedhjeve.

5. Brenda periudhës nga publikimi i listave, sipas paragrafit 4 të këtij neni, secili student ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes një deklaratë me shkrim e cila mund t'i parashtrahet KQZ-së.
6. Ankesat kundër listës së studentëve me të drejtë vote duhet të paraqiten më së voni brenda tri ditëve pas shpalljes së listave, dhe KQZ-ja duhet të vendosë për ato kundërshtime brenda 24 orëve pas pranimit të tyre. Vendimi i KQZ-së, në lidhje me ankesat, është përfundimtar në procedurë administrative.

Neni 13

Përfaqësimi gjinor në Këshillin e Studentëve

1. Këshilli i studentëve duhet të ketë përfaqësim të denjë gjinor, për detaje të tjera të përfaqësimit gjinor të listës së kandidatëve, KQZ-ja i referohet Ligjit për Barazi Gjinore dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 14

Vlefshmëria e listës së kandidatëve

1. Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga KQZ, nëse një kandidat nuk i plotëson kushtet e parapara me këtë rregullore për aplikim, atëherë kandidati refuzohet nga KQZ për tu përfshirë në listën e kandidatëve për KS.
2. Në rast të parregullsive të evidentuara nga KQZ, kandidatit i dërgohen arsyet e refuzimit dhe shpjegimet e nevojshme për përmirësim.
3. Kandidati brenda një afati prej 48 orësh duhet të dërgoj në KQZ përmirësimet apo dëshmitë që kandidati plotëson kushtet për kandidim.

Neni 15

Mbajtja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet mbahen në ditën e caktuar nga Këshilli Drejtues.
2. Zgjedhjet do të përfundojnë në orën 16:00, përjashtimisht nëse në kohën e mbylljes së vendvotimeve ka radhë votuesish; atëherë koha e mbylljes shtyhet deri në votimin e studentit të fundit.
3. Numrin e vendvotimeve e cakton KQZ.

Neni 16

Qasja në vendvotim

1. KQZ është i obliguar që të ofrojë vendvotime të përshtatshme për zgjedhje. Pajisjet e nevojshme, si kutitë e votimit, kabinat e votimit, dhe pajisje të tjera të nevojshme sigurohen nga KQZ.
2. Gjatë procesit zgjedhor, përveç anëtarëve të KQZ-së, në vendvotime mund të kenë qasje:
 - Vëzhguesit zyrtarë të zgjedhjeve;
 - Votuesit;
 - Personeli tjetër zyrtar i caktuar.
3. Pas hedhjes së votës, votuesit duhet të largohen menjëherë nga vendvotimi.
4. Nëse nevojitet për rregullsinë e procedurës, kryesuesi i KQZ-së mund të kufizojë qasjen e votuesve në vendvotim sipas radhës.
5. Në hyrje të vendvotimeve nuk lejohet prezenca apo qëndrimi i kandidatëve për anëtar të KS.

Neni 17

Kabina e votimit

1. Secili vendvotim duhet të ketë së paku një kabinë votimi.
2. Kabina e votimit duhet të vendoset në mënyrë që të sigurojë fshehtësinë e votimit.
3. Gjatë procesit të votimit, ndalohet përdorimi i telefonit dhe fotografimi i votës. Shkeljet do të ndëshkohen sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 18

Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor

1. Fletëvotimet dhe materiali zgjedhor përgatiten nga KQZ dhe shpërndahen në kampuse.
2. Fletëvotimet duhet të palosen së paku njëherë para hedhjes në kutinë e votimit.

Neni 19

Respektimi i procedurave zgjedhore

1. KQZ është përgjegjëse për respektimin e procedurave zgjedhore në pajtim me rregulloren për zgjedhje.
2. Çdo parregullsi në lidhje me procedurat zgjedhore raportohet sipas kësaj rregulloreje.

Neni 20

Mënyra e votimit

1. Votimi duhet të bëhet personalisht. Personat me aftësi të kufizuara mund të zgjedhin një person për ndihmë gjatë procesit të votimit.
2. Përveç përjashtimeve, në kabinën e votimit lejohet të hyjë vetëm një votues.

Neni 21

Verifikimi i votuesve

1. Secili votues është i obliguar të dëshmojë identitetin përmes ID kartelës së studentit para KQZ-së.
2. Pranueshmëria bazohet ekskluzivisht në listën e votuesve me të drejtë vote.

Neni 22

E drejta e votës dhe gabimi gjatë votimit

1. Secili student me të drejtë vote ka të drejtë të votojë për shtatë (7) kandidatë për KS.
2. KQZ e drejton votuesin në kabinën e votimit.
3. Votuesi mbush fletëvotimin, e palos dhe e vendos në kutinë e votimit.
4. Në rast gabimi gjatë mbushjes së fletëvotimit, KQZ duhet t'i japë votuesit një fletëvotim të ri, dhe fletëvotimi i gabuar anulohet.
5. Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokoll.

Neni 23

Regjistrimi i votuesve

1. Studenti që ka hedhur votën regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtar i KQZ-së, përmes Formularit
2. Emri duhet të regjistrohet me numrin e tij të rendit nga lista e votuesve.
3. Një anëtar tjetër i KQZ-së duhet të evidentojë emrin e votuesit në listën e votuesve.

Neni 24

Qartësimi i identitetit të votuesit

1. Identiteti i votuesit duhet të qartësohet përmes dokumentit të identifikimit.
2. Nëse identiteti nuk mund të qartësohet, studenti nuk lejohet të votojë.
3. Pas dorëzimit të fletëvotimit, asnjë dyshim tjetër për identitetin nuk merret parasysh.

Neni 25

Përmbajtja dhe formati i fletëvotimit

1. Për fletëvotim përdoret formulari i Fletëvotimit sipas Formularit që përgatitet nga KQZ.
2. Përgatitja e fletëvotimeve bëhet nga KQZ-ja sipas dinamikës së përcaktuar.

Neni 26

Vlefshmëria e fletëvotimit

1. Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm kur votuesi qartë shënon kandidatin apo organizatën e zgjedhur me një "X" ose "√" pranë emrit.

Neni 27

Fletëvotimi i pavlefshëm

1. Fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm nëse:
 - Fletëvotimi është i grisur në mënyrë që të mos kuptohet për kë është votuar;

- Asnjë kandidat nuk është shënuar;
 - Më shumë se shtatë (7) kandidat janë shënuar;
 - Shenjat janë të tilla që nuk tregojnë qartë për kë është votuar.
2. Fjalët apo shenjat e tjera në fletëvotim e bëjnë atë të pavlefshëm.

Neni 28

Numërimi i votave dhe dorëzimi i rezultateve

1. Pas përfundimit të votimeve, kryesuesi i KQZ-së shpall përfundimin e votimeve. Vendvotimi mbyllet nga anëtarët e KQZ-së në prani të vëzhguesve të certifikuar.
2. KQZ zbraz kutitë e votimit dhe:
 - 2.1. Numëron fletëvotimet për secilin kandidat të votuar;
 - 2.2. Konstaton numrin e përgjithshëm të votuesve;
 - 2.3. Nëse ka mos përputhje, identifikon arsyet.
3. Rezultatet dorëzohen kryesuesit të KQZ-së në kopje të fortë dhe elektronike menjëherë pas numërimit.

Neni 29

Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve

1. Rezultati preliminar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ brenda 24 orëve pas përfundimit të zgjedhjeve.
2. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve duhet të publikohet nga KQZ më së largu 5 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve.
3. Shpallja duhet të përmbajë:
 - 3.1. Rezultatit e zgjedhjeve në numra;
 - 3.2. Listën e kandidatëve për anëtar të KS.

Neni 30

Ankimimi ndaj procesit zgjedhor

1. Kundërshtimet ndaj shkeljeve të procedurave dhe rezultateve të zgjedhjeve duhet të dorëzohen tek KQZ brenda 24 orëve pas shpalljes së rezultateve preliminare.
2. Kundërshtimet eventuale të studentëve/kandidatëve për KS ndaj rezultateve shqyrtohen nga KQZ brenda 24 orëve pas pranimi të tyre.
3. Çdo ndryshim në rezultatet e zgjedhjeve për arsye të pranimi të ankesave duhet të shpallet publikisht nga KQZ.
4. Vendimi i KQZ i IBCM është përfundimtar në procedurë administrative.

Neni 31

Përsëritja e procesit zgjedhor

1. Nëse KQZ konstaton se shkeljet e procedurave zgjedhore kanë ndikuar ndjeshëm në rezultatin zgjedhor, procesi do të përsëritet sipas së njëjtës procedurë, vetëm në fakultetin përkatës, brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 32

Parimet e konstituimit të Këshilli të Studentëve

1. Këshilli i Studentëve duhet të konstituohet brenda 7 ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Këshilli i Studentëve konsiderohet i konstituuar me zgjedhjen e kryetarit.
2. Mbledhjen konstituive të këshillit e udhëheq sekretari i përgjithshëm. Mbledhja konstituive thirret brenda 7 ditëve pas certifikimit të zgjedhjeve.

Neni 33

Zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Studentëve

1. Kryetari i KS duhet të zgjidhet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KS. Kryetari i KS zgjidhet gjatë mbledhjes së kryesuar nga kryetari i KQZ-së.
2. Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk fiton shumicën absolute të votave të anëtarëve në raundin e parë të votimit, atëherë organizohet raundi i dytë për kandidatin me numrin më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave absolute as në raundin

- e dytë, atëherë kandidati konsiderohet i refuzuar dhe procedura rifillon, ku kandidati i refuzuar më parë largohet nga kandidatura.
3. Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet dy herë. Nëse përsëri ka vota të barabarta pas raundeve të përsëritura, procedura rifillon sipas dispozitave të këtij neni.
 4. Nëse asnjë kandidat nuk arrin shumicën absolute të votave pas tri raundeve të njëpasnjëshme, raundi i katërt dhe vendimtar i votimit mbahet me tre kandidatët paraprakisht të refuzuar. Kandidati që fiton shumicën e thjeshtë të votave zgjidhet kryetar. Në rast të votave të barabarta, kandidatët me më shumë vota garojnë në raundin e dytë të votimit.
 5. Nëse votat mbeten të barabarta edhe pas tri raundeve të njëpasnjëshme të votimeve, mbledhja konstituive ndërpritet dhe thirret përsëri nga kryesuesi i KQZ-së brenda 48 orëve.
 6. Pas mbledhjes së përsëritur, të gjithë kandidatët e refuzuar gjatë procedurave paraprake të votimit përjashtohen nga kandidatura për pozitën e kryetarit. Procedura zgjedhore rifillon duke u bazuar në dispozitat e këtij neni.
 7. Pas zgjedhjes së kryetarit, zgjidhet sekretari me shumicën e thjeshtë të votave përmes votimit të hapur.
 8. Pas zgjedhjes së kryetarit dhe sekretarit, kryesuesi i KQZ-së ia dorëzon udhëheqjen e mbledhjes kryetarit të zgjedhur, ndërsa procesverbali i dorëzohet sekretarit të zgjedhur.

Neni 34

Shkarkimi i kryetarit dhe sekretarit të Këshillit të Studentëve

1. Kryetari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave (50% +1) përmes një votimi nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KS.
2. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit, nënkryetari i parë e merr kryesimin e përkohshëm dhe brenda shtatë ditëve thërret mbledhjen për rizgjedhjen e kryetarit.
3. Sekretari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave (50% +1) përmes një votimi nga numri i anëtarëve të pranishëm të KS.
4. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të sekretarit, kryetari cakton një nga dy nënkryetarët për të marrë përkohësisht detyrat e sekretarit pa ndonjë vonesë.

Neni 35

Mbledhjet e KS

1. Kryetari thërret dhe kryeson mbledhjet.
2. Nëse kryetari nuk mund të kryesojë mbledhjen, atëherë e kryeson nënkryetari i parë. Nëse asnjëri nuk mund të marrë pjesë, sekretari i KS e kryeson mbledhjen.
3. Kryesuesi thërret takimet e KS sipas nevojës. Gjatë periudhës së studimeve, mbledhjet e rregullta të KS mbahen të paktën njëherë në muaj, në përputhje me nevojat.
4. Takimet e jashtëzakonshme të KS mund të mbahen në çdo kohë, por rendi i ditës kufizohet në një pikë të vetme.
5. Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit dhe të nënkryetarëve, Këshilli Drejtues autorizon sekretarin e përgjithshëm për të filluar procedurat zgjedhore për kryetarin e ri.
6. Mbledhjet e KS duhet të jenë të hapura për publikun, përveç rasteve kur vendoset ndryshe.
7. Anëtarët e KS duhet të ftohen së paku 3 ditë para mbledhjes, përmes e-mailit ose me shkrim.
8. Kryesuesi mund të ftojë ekspertë për mbështetje profesionale në mbledhje.
9. Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhje nëse e kërkon një e treta e anëtarëve të KS me një propozim të arsyetuar.

Neni 36

Pjesëmarrja në mbledhje dhe zëvendësimi

1. Të gjithë anëtarët e këshillit të studentëve janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje.
2. Gjatë mbledhjeve të këshillit të studentëve, anëtarët votojnë vetëm personalisht, pa të drejtë delegimi.
3. Anëtarët duhet të nënshkruajnë listën e pjesëmarrjes. Anëtari mund të mungojë për arsye të arsyeshme dhe duhet të njoftohet me kohë.
4. Nëse një anëtar mungon për 6 muaj me radhë, mandati i tij/saj përfundon.
5. Zëvendësimi bëhet me kandidatin tjetër sipas numrit rendor të votave të fituara nga procesi zgjedhor.

Neni 37

Fillimi i mbledhjes dhe aprovimi i rendit të ditës

1. Kryesuesi hap, kryeson dhe mbyll mbledhjen.
2. Rendi i ditës përgatitet nga kryesuesi në bashkëpunim me nënkryetarët dhe sekretarin.
3. Kryesuesi është i obliguar të përfshijë kërkesat me shkrim të dorëzuara së paku 48 orë para mbledhjes.
4. Mbledhjet e KS duhet të kenë kuorumin prej 50% +1 të anëtarëve.
5. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi verifikon pjesëmarrësit dhe rendin e ditës.
6. Anëtarët e KS kanë të drejtë të propozojnë ndryshime në rendin e ditës.
7. Materialet e dorëzuara gjatë mbledhjes mund të aprovohen me shumicën absolute të votave.

Neni 38

Vendimmarrja

1. Vendimet e këshillit të studentëve janë të vlefshme nëse arrihet kuorumi prej 50% +1 të anëtarëve.
2. Kryesuesi formulon propozimet për vendim dhe vendos ato në votim.
3. Këshilli i studentëve merr vendim me shumicën e thjeshtë të votave, përveç rasteve të specifikuara në këtë rregullore.
4. Votimi bëhet përmes ngritjes së dorës, aklamacionit, ose votimit të fshehtë, varësisht nga vendimi.

Neni 39

Votimi i fshehtë

1. Votimi i fshehtë zbatohet nga një komision prej tre anëtarëve të zgjedhur nga KS.
2. Pas votimit, kryesuesi konfirmon rezultatin.

1. Votimi i fshehtë kërkohet për:
 - Zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit,
 - Shkarkimin e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit,
 - Çështje me ndikim në jetën private të anëtarëve.
2. Numërimi i votave bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit.

Neni 40

Mbajtja e rendit në mbledhjet e KS dhe shqiptimi i masave

1. Kryesuesi është përgjegjës për ruajtjen e rendit.
2. Masat për shkeljen e rendit përfshijnë:
 - Vërejtje me gojë,
 - Marrjen e fjalës,
 - Përrjashtimin nga mbledhja.

Neni 41

Procesverbali i mbledhjeve të KS

1. Procesverbali duhet të mbahet për secilin takim.
2. Ai duhet të përmbajë detaje mbi vendin, kohën, rendin e ditës dhe vendimet e marra.
3. Procesverbali aprovohet në mbledhjen vijuese.

Neni 42

Puna e komisioneve të KS

1. KS propozojnë studentë për të marrë pjesë në komisionet ndihmëse të kolegjit.
2. Studentët e propozuar duhet të kenë notë mesatare së paku shtatë (7) sipas sistemit të notimit të IBCM dhe të mos jenë përsëritës.

Neni 43

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për anëtarët e këshillit të studentëve, si dhe për të gjithë personat e tretë të ftuar apo të përfshirë në procedurat e KS.
2. KQZ, kryetari i KS janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Për çështjet që nuk janë paraparë në këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe Statutit të IBCM. Në rast të ndonjë konflikti mes dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të tjera, vlejnë dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe të Statutit të IBCM.
4. Për të gjitha çështjet lidhur me vendimet apo procedurat e kontestuara në lidhje me këtë rregullore, Këshilli Drejtues i IBCM do të marrë vendimin përfundimtar.
5. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e bën Këshilli Drejtues.

Neni 44

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM)

Prof. Dr. Bedri Peci

Kryesues i Këshillit Drejtues të IBCM



Mitrovicë, _____

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TË IBCM****SHTOJCA NR.1 - FORMULAR APLIKIMI
për zgjedhjet e studentëve në IBCM**

T'i dorëzohet Komisionit Qendror Zgjedhor jo më vonë se deri më ___ / ___ / _____ në orën 15:00
(në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm ose përmes postës zyrtare elektronike në e-mail adresën e
sekretarit të përgjithshëm dhe të kryesuesit të KQZ).

Dua të regjistrohem si kandidat për anëtar të Këshillit të Studentëve:

Emri dhe Mbiemri _____

Fakultetit _____

Viti i studimeve _____

Data e lindjes _____

Nr. personal _____

Nr. i studentit _____

Data _____

Nënshkrimi _____



SHTOJCA NR. 2 - FORMULARI PËR ANKESA
Komisioni Qendror Zgjedhor

FOMULARI I ANKESËS¹

(t'i dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të dorëzohet në formë fizike në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm)

PARASHTRUESI I ANKESËS:

Emri dhe mbiemri: _____

Fakulteti: _____

Nr. personal _____

Nr. i studentit _____

SHKELJA E SUPOZUAR

Të përshkruhet shkelja e supozuar në hollësi (vendi, data dhe koha kur ka ndodhur shkelja e supozuar). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiten fletë shtesë.

Data:

Nënshkrimi:

¹ Për çdo shkelje të supozuar kërkohet një formular i veçantë.